РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr________

_________г./v.

ДКСК KSHPK
ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë KSHPK), në seancën e 86-të të mbajtur më 05.05.2023, miratoi sa vijon.

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-7453/1 të datës 29.12.2021, me pretendime për parregullsi në zbatimin e procedurës sipas shpalljes për punësim. **NDËRPRITET**

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent për arsye se denoncimi përmban pohime për të cilat KSHPK-ja ka vepruar sipas lëndës me të njëjtat pretendime dhe ka ndërmarr veprime sipas të njëjtave – ka miratuar vendim nga kompetencat e saj.

Lënda me numër 12-7453/1 të datës 29.12.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi të publikohet në formë të depersonalizuar në ven faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 29.12.2021 është dorëzuar denoncim me pretendime për parregullsi gjatë zbatimit të procedurës sipas shpalljes për punësim dhe është formuar lënda me numër 12-7453/1 të datës 29.12.2021.

Në denoncim, parashtruesi thekson se në procedurën në vijim të konkursit për punësim me numër /// të publikuar nga ///, përveç intervistës, nuk është kryer asnjë testim tjetër kualifikimi dhe se përzgjedhja e kandidatit të përshtatshëm për vendin e punës. /// – / // në redaksinë e gjuhës vllahe u krye në baza partiake.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se pas një raporti në të cilin janë paraqitur të njëjtat procesverbale faktike të pretendimeve, ka konstatuar lëndën me numër 12-316/1 datë 01.02.2022, për të cilën ka vepruar - ndërmarrë veprime në përputhje me kompetencat e veta ligjore, dhe atë konstatimin e gjendjes faktike sipas të njëjtës në seancën e 74-të të mbajtur më 09.05.2022 ka marrë vendim me numër 12-316/5 të datës 09.09.2022, të publikuar në veb faqen e internetit të KSHPK-së.

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk

Nga aty, KSHPK-ja vlerësoi se në lëndën me numër 12-7453/1 të datës 29.12.2021 nuk ka elemente për veprim kompetent, sepse kërkesa përmban pretendime për të cilat KSHPK-ja tashmë ka vepruar në një rast me të njëjtin përshkrim faktik të pretendimeve dhe ka vendosur në lidhje me të njëjtën – ka vendim të miratuar nga kompetencat e saj.

Duke pasur parasysh të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar :
- parashtruesi i denoncimit

Përpiloi: A.R.M.
Miratoi: G.T., anëtar

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetar
Biljana Ivanovska